



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "DAQA" Sh.P.K. të datës 26.05.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parqeve në hapësira gjelbëruese dhe shndërrimi i oborreve të shkollave në parqe të qasshme" me nr. të prokurimit 616-26-2956-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "DAQA" Sh.P.K. të datës 26.05.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parqeve në hapësira gjelbëruese dhe shndërrimi i oborreve të shkollave në parqe të qasshme" me nr. të prokurimit 616-26-2956-5-2-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "DAQA" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 26.05.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parqeve në hapësira gjelbëruese dhe shndërrimi i oborreve të shkollave në parqe të qasshme" me nr. të prokurimit 616-26-2956-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi nr. 1: Kërkesat për pajisje si më poshtë janë pajisje absolutisht të panevojshme rrjedhimisht edhe diskriminuese dhe të kundërligjshme. Prandaj kërkojmë që këto pajisje duhet të largohen.

4. Eskavator me kapacitet 9-10T, me atest - të largohet kërkesa për atest sepse është diskriminuese për faktin që askush (ose vetëm 1-2 OE e kanë atestin e tillë në RKS).

18. Hillt me derivate - kërkesa që hillti të jetë me derivate është e panevojshme sepse edhe një hillt normal mund të kryen punën e njëjtë andaj kërkojmë të revidohet kjo kërkesë ashtu që në vend të hilltit me derivate të kërkohet vetëm hillt i cili kryen punën e njëjtë.

Gjithashtu në kërkesat më poshtë kërkohet gjeneratori i cili mund të përdoret për hilltin e thjeshtë dhe nuk ka nevojë për atë me derivate!

Po ashtu kërkojmë që të ndryshohet kërkesa për kamion me kiper 15-20T nga kufizimi i peshës 15-20T në min.15T. Pra kërkesa si vijon:

13. Kamion kipper 15-20T - të ndryshohet në kamion kipper min. 15T.

Pretendimi nr. 2: Kërkesa për dy persona të certifikuar për instalim të ndriçimit është kërkesë absolutisht e panevojshme dhe e diskriminuese. Në cilin pozicion kërkohet ekspertiza e tillë?! Cila qenka ajo punë ku duhet të angazhohen 2 persona dhe atë të certifikuar për instalim të ndriçimit? Kush i ka certifikuar ata persona? Pra ekzistojnë shumë pyetje retorike sipas të cilave jo vetëm ligjërisht por edhe logjikisht mund të konfirmohet që këto janë kërkesa absolutisht diskriminuese, të panevojshme dhe të kundërligjshme. Rrjedhimisht kërkojmë nga AK që të largoj kërkesën si vijon:

2.15 - Dy te certifikuar per instalim te ndicimit

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, është gjetur se kërkesat për stafin profesional konkretisht për stafin dhe makinerinë janë absolutisht të domosdoshëm për të garantuar realizimin e projektit në mënyrë efikase dhe efektive. Duhet sqaruar se kërkesat e DT janë vendosur në përputhje të plotë me qëllimin dhe specifikat e aktivitetit të prokurimit. Sipas nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësi kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësi kërkuese.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 01.06.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.